



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Iliç META



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2014**

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur e vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve, të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë;
- Duke vlerësuar kontributin e saj në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit finanziar e bankar;
- Duke përmirësuar kuadrin ligjor, në përshtatje me kuadrin e përgjithshëm të direktivave dhe të udhëzimeve të BE-së;
- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e saj me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në drejtim të:

- Rritjes së kompetencave dhe konsolidimit të pozicionit të pavarur të Agjencisë si institucion organizues, mbikëqyrës dhe realizues i procesit të sigurimit dhe kompensimit të depozitave;
- Automatizimit të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, në funksion të një procesi kompensimi të shpejtë dhe të saktë;
- Administrimit me efektivitet të mjeteve financiare, duke diversifikuar portofolin me investime në maturitet më të gjatë;
- Përmirësimit të skemës së sigurimit të depozitave, në përputhje me standartet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;
- Vendosjes dhe thellimit të bashkëpunimit me organizmat dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, në tërheqjen e politikave më të mira apo asistencës teknike të nevojshme.

Kuvendi kërkon që Agjencia e Sigurimit të Depozitave për vitin 2015 të përmirësojë punën në drejtim të:

- Rishikimit të listës së përjashtimeve nga mbulimi dhe mundësinë e zgjerimit të mbulimit të sigurimit të depozitave të ndërmarrjeve. Me rritjen e përvitshme të raportit të mbulimit dhe rritjen e raportit të mbulimit, që sigurohet nga përfitimi i linjës së kredisë, Agjencia e Sigurimit të Depozitave mund të zvogëlojë nivelin e primeve që ajo mbledh.

- Hartimit të akteve nënligjore për një plan konkret kompensimi, procedura standarde pune, si dhe detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për stafin e Agjencisë, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të funksionimit të skemës së sigurimit të depozitave, në përputhje me standardec ndërkontinentale për skema efektive të sigurimit të depozitave.

- Bashkëpunimit të mëtejshëm me të gjitha institucionet e tjera të rrjetit të sigurisë financiare, Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve për securinë dhe sfidat e tregut bankar dhe financiar, duke kontribuar në forcimin dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.

- Forcimit të rolit të saj në drejtim të edukimit dhe rritjes së besimit të publikut në bankat dhe institucionet e tjera financiare, nëpërmjet rritjes së nivelit të informimit të publikut për skemën e sigurimit të depozitave.

Miratuar në datën 11.6.2015